



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për periudhën 6 ( gjashtë ) muaj dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik si dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.05/2014,për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e procedurave për Themelimin e Mardh enjës së Punës në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ nr.04/2016 për rregullimin e procedures së rekrutimit për punësimet me kontrata të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nenshtrohen Ligjit për Detyrime, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës shpallë këtë:

## KONKURS

**Nr.08.2018**  
**Për angazhim të përkohshëm**

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar i teknologjisë informative një pozitë**

**Kategoria Funksionale: Niveli profesional**

**Koeficienti: 7 (shtatë)**

**Kohëzgjatja e angazhimit: Me afat të caktuar, tre(3) muaj me mundesi vazhdimi**

**Raporton tek: Kryetari**

**Vendi: Prishtinë**

**Qëllimi i postit:** Të ofrojë shërbime të mbështetjes të teknologjisë informative për zyrtarët në Sekretariatit e Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në përdorimin e teknologjisë në punë, mbështetë stafin në eliminimin e problemeve të shkallës së parë në përputhje me standardet dhe procedurat ekzistuese.

**Detyrat Kryesore:**

1. Përkrahë të punësuarit në përdorimin e të gjitha aplikacioneve që janë të aprovuara për tu instaluar në KGJK .....30%
2. Kryen shërbimet e mirëmbajtjes dhe konfigurimit të kompjuterëve dhe sistemeve operative....15%
3. Eviton problemet e zakonshme gjatë përdorimit të kompjuterëve, përcakton shkakun e problemeve dhe ndërmerr veprime korrektuese. ....15%

4. Këshillon të punësuarit në lidhje me veprimet që duhet ndërmarrë për t'i korrigjuar problemet në përdorimin e kompjuterëve dhe aplikacioneve të instaluar.....10% U përgjigjet pyetjeve të të punësuarve në lidhje me përdorimin e aplikacioneve zyrtare të aprovuara në KGJK, duke përfshirë ofrimin e përgjigjeve me telefon , email dhe mjete tjera të komunikimit.....10%
5. Kryen instalimin e pajisjes, instalimin e pjesëve shtesë dhe ndërrimin e pjesëve brenda pajisjes si dhe instalimin e aplikacioneve.....5%
6. Përpilon udhëzues dhe doracakë për përdorimin e pajisjes dhe aplikacioneve në KGJK.....5%
7. **Ofron trajnime për të punësuar gjatë punës së përditshme si dhe në trajnime të organizuar enkas.**
8. Kryen detyra dhe kontribuon në realizimin e projekteve të TIK-ut në KGJK. Krijon dhe mirëmban sistemin e përcjelljes dhe evidencimit të ndërhyrjeve për shërbimet e ofruara.....5%

**Shkathtësitë aftësitë e kërkuara:**

1. Të ketë njohuri në teknologji informataive dhe komunikim
2. Të njohë mirë administrimin e rrjetave VPN-ve.
3. Të ketë aftësi dhe shkathtësi për të eliminuar defektet e ndryshme të rrjetit LAN dhe WAN.
4. Të ketë përvojë në ofrimin e trajnimeve bazike nga përdorimi i kompjuterëve.

**Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë post:**

1. Diplomë universitare pa përvojë ose shkolle e larte me 2 vite përvojë pune profesionale-----E nevojshme.

**Shënim:** Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatet e jashtëm si dhe për nëpunësit civil ekzistues.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me rregullativen ligjore të cekur më lartë.

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Supreme të Kosovës-Pallati i Drejtësisë , objekti E- Lagjja "Prishtina e Re", Rr.:" Nekibe Kelmendi" pn, ose:

SHKARKO APLIKACIONIN

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet edhe përmes postes.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 038/200-17427, prej orës 08:00 - 16:00.

**Konkursi është i hapur 3 ditë** nga dita e publikimit në web-faqen zyrtare dhe tabelën e shpalljeve të Gjykatës Supreme, duke filluar nga data **07.07.2018**, deri më datën **09.07.2018**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijn brenda 2 ditësh, aplikacionet që arrijn pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Përdorimi i aplikacionit/formularit të gabuar do të konsiderohet i pa vlefshëm.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.